



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.123 dt.26.10.2001

**PROPOZIM PER KALIM NE FOND BANESE PER AMBJENTIN QE NDODHET  
NE RRUGEN "BAB REXHA", PALLATI NR.10/1 TIRANE DHE PAJISJE ME  
AUTORIZIM DEFINITIV DHE PRIVATIZIM PER QYTETAREN HAVA MERSINI**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.26.10.2001 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore "Propozim për kalim në fond banese për ambjentin që ndodhet në rrugën "Bab Rexha", pallati Nr.10/1 Tiranë dhe për pajisje me autorizim definitiv dhe privatizim për qytetaren Hava Mersini" në zbatim të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, pika e të VKM-së Nr.49 dt.29.01.93 "Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët"

**V E N D O S I**

1. Të kalojë në fond banese ambjenti ish zyrë fronti që ndodhet në Rr.Bab Rexha, Pll 10/1 sipas genplanit bashkëngjitur dhe të pajiset me autorizim definitiv dhe privatizim qytetarje Hava Mersini
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



